




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



Nr. 374/1 prot.

Shkodër, më 04.06.2025

Lënda: Mbi Vendimin nr. 17, datë 30.05.2025 të Këshillit Bashkiak Fushë Arrëz

KËSHILLI BASHKIAK FUSHË ARRËZ

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të nryshuar, neni 24, neni 53, pika 6, të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të VKM nr. 597, dt. 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind", i ndryshuar, të VKB Fushë Arrëz nr. 2, datë 27.01.2025 "Për miratimin e kriterëve për përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i ndihmës ekonomike i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% për vitin 2025", shqyrtoi VKB Fushë Arrëz nr. 17, datë 30.05.2025 "Për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Prill 2025 për njësitë administrative, Fushë Arrëz, Iballë, Qafë Mali, Blerim dhe Fierzë".

Për sa më trajtuar, në zbatim të Urdhërit të Prefektit të Qarkut Shkodër nr. 40, datë 29.05.2025 "Për delegim kompetence për firmë", ju autorizohet procedimi i mëtejshëm për 30 familje në shumën 118 630 lekë, duke përdorur deri në 6% të fondit total të ndihmës ekonomike prej 2 011 116 lekë për muajin Prill 2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI

**NË MUNGESË, DELEGIM
NËNPREFEKTI**

Hysen HYSAJ

